



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA SHËRBIMIT SOCIAL

SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MONITORIMIT PËR SHËRBIMET SOCIALE DHE

SHËNDETIN PUBLIK

RELACION

PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2026 – 2030 NË BASHKINË DURRËS

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 64/2025, datë 6.11.2025 “Për barazinë gjinore”, Ligjin 57/2019 10.03.2005 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.121, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”, Planin Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2023-2025, si dhe në zbatim të Urdhërit të Kryetares së Bashkisë nr. 126, datë 08.04.2026 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Barazisë Gjinore në Bashkinë Durrës” u përgatit nga Bashkia Durrës Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2026 – 2030, si mjet kryesor për zbatimin e angazhimeve publike për barazinë gjinore, të ndërmarra nëpërmjet nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore¹. Ky plani i tretë i veprimit u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, Aleancën e Grave Këshilltare dhe anëtare e anëtarë të Këshillit Bashkiak. I gjithë procesi u mbështet nga UN Women Shqipëri në kuadër të zbatimit të projektit: “Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore II - Instrumenti i Lehtësimit të Barazisë Gjinore në Shqipëri” (EU4GE II), që financohet nga Bashkimi Evropian.

PVVBGJ 2026-2030 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me planin e mëparshëm të veprimit për barazinë gjinore², përfshirë vështirësitë apo sfidat e ndeshura për zbatimin e tij, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore. Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2026 - 2030 mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030**.³

¹ Teksti i Kartës në gjuhën shqipe mund të aksesohet në:

https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

² Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2023-2025, miratuar në Këshillin Bashkiak në dhjetor 2022 .

³ Miratuar me VKM nr.400, datë 30.06.2021. Shiko: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

Në përgatitjen e PVVBGJ Bashkia Durrës ka marrë në konsideratë edhe komunikimet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë procesit të vlerësimit të SKBGJ, sidomos në lidhje me drejtimet prioritare për vitet në vijim. Në këtë kuadër, Bashkia Durrës ka reflektuar në PVVBGJ 2026–2030 gjetjet dhe sfidat e identifikuar në nivel vendor, duke i lidhur ato me prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, veçanërisht në drejtim të forcimit të mekanizmave institucionalë, parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe nevojës për rritjen e ndërhyrjeve në fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave.

Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave, mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më qartë domosdoshmërinë e gjithë përfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja “nga të gjithë grupet”, që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë, të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, emigrante, azilkërkuese, etj., pra nga të gjithë grupet në shoqëri.

Të gjitha masat dhe veprimet e paraqitura si pjesë e PVVBGJ 2026 – 2030, janë shoqëruar me të dhëna lidhur me treguesit e rezultateve, drejtoritë kryesore përgjegjëse dhe institucionet e organizatat partnere në zbatim, afatet kohore, përgjegjësitë për monitorim, ndërsa procesi i kostimit të draft PVVBGJ 2026-2030 është parashikuar të zhvillohet paralelisht me procesin e konsultimit publik, duke filluar nga takimi specifik me grupin e punës, në datën 29 prill 2026. Ky proces do të finalizohet pasi të ketë përfunduar tërësisht rishikimi i matricës së PVVBGJ dhe të jenë saktësuar të gjitha masat dhe veprimet që do përmbajë ky dokument. Këto patjetër që janë lidhur dhe me fushat e ndërhyrjes, rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit përkatës dhe dokumentat kryesorë ku mbështeten hapat e planifikuar.

Vizioni i këtij Plani është : “Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Durrësit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantëve/emigrantit, të azilkërkuësës/azilkërkuësit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

PVVBGJ 2026 - 2030 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030. Gjithashtu në formulimin e këtyre fushave të ndërhyrjes dhe objektivave specifike janë mbajtur në konsideratë edhe objektivat e parashikuara në Strategjinë e BE për Barazinë Gjinore 2026-2030, si dhe masat dhe veprimet e parashikuara në EU GAP III 2021-2027.

Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Fuqizimi ekonomik dhe rritja e pjesëmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në tregun e punës dhe zhvillimin vendor.

- II. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, në jetën publike dhe vendimmarrjen në nivel vendor, në funksion të një qeverisjeje gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.
- III. Parandalimi dhe adresimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe forcimi i sigurisë, reziliencës dhe menaxhimit gjithëpërfshirës së emergjencave në komunitet.
- IV. Konsolidimi i mekanizmave institucionalë, integritit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në politikat dhe qeverisjen vendore.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe për sa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumenteve të tjerë kryesorë ku mund të referohemi, në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, bizneset, median, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore.

Mbledhja dhe përditësimi i rregullt i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparenca e llogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të përparuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

PVVBGJ 2026–2030 mbështetet në një *qasje transformuese gjinore*, e cila synon jo vetëm fuqizimin e grave dhe vajzave, por edhe transformimin e normave shoqërore, roleve tradicionale gjinore dhe strukturave institucionale që riprodhojnë pabarazitë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.

DREJTORE

Diola Xhango